

## **Shëndeti dhe siguria në punë – Distancimi fizik**

Puna në kontakt të afërt rrit rrezikun e të qenurit të ekspozuar në COVID-19.

Këshillimi shëndetësor i tanishëm ([health advice](#)) është që çdo njëri, përfshirë njerëzit në vendet e punës, duhet të zbatojnë masat për distancim fizik kur do që është e mundur.

Ju duhet të konsultohuni me punëtorët dhe përfaqësuesit e shëndetit dhe sigurisë për çështjet e shëndetit dhe sigurisë në lidhje me COVID-19.

### **Çfarë është distancimi fizik?**

Aty ku është e mundur secili duhet të mbanë largësi prej së paku 1.5 metra nga të tjerët (jashtë familjes së tyre)

Disa shtete dhe territore ([states and territories](#)) gjithashtu mund të kenë kufizime në numrin total të njerëzve që mund të jenë present në vendin e punës në të njëjtën kohë.

### **Çfarë masa për distancim fizik mund të zbatojnë punëdhënësit në vendin e punës?**

#### **Renditja**

Mund të ketë nevojë për ridizajnimin e renditjes së vendit të punës dhe për rrjedhën e punës për të siguruar distancim fizik. Konsideroni vënien e shenjave në dyshime dhe mure për të identifikuar kërkesat e distancimit.

Nëse ndryshoni renditjen fizike të vendit të punës, renditja juaj duhet t'i mundëson punëtorëve të hyjnë, dalin dhe lëvizin sigurt nëpër vendin e punës, për të dyja, për kushte normale të punës dhe për urgjencë.

#### **Takimet dhe trajnimi**

Aty ku takimet e personelit janë esenciale, përdorni opsione që nuk janë të drejtpërdrejta siç është tele apo video konferenca.

Nëse opsioni jo i drejtpërdrejt nuk është i mundur, kufizoni kohën e takimit dhe numrin e njerëzve.

Sigurohuni që njerëzit janë larg së paku 1.5 metra. Nëse është brenda, siguroni ventilim adekuat.

## Hapësirat e vendit të punës

Shpërndani mobiljet dhe reduktoni numrin e punëtorëve që përdorin hapësira të përbashkëta në kohë të caktuar, siç është shpërndarja në kohën e pauzave për ushqim.

Në ashensore, sirugohuni që punëtorët të qëndrojnë larg 1.5 metra, nëse është e mundur.

Vendosni shenja për distancim fizik. Uebfaqja ka linqe për një varg të postereve dhe resurseve ([of posters and resources](#)).

Konsideroni sigurimin e hapësirave të veçanta, për shembull banjo të veçanta për punëtorë dhe vizitorë.

## Dërgimet, kontraktuesit dhe vizitorët

Secilit që hyn në vendin e punës jepni udhëzime të qarta për kërkesat për derisa janë në vendin e punës. Për shembull, duke qëndruar në automjete, duke përdorur telefonat për kontakt dhe duke përdorur dokumente elektronike.

Minimizoni numrin e punëtorëve që merren me dërgesat dhe kontraktuesit. Siguroni të ketë në dispozicion hapësira për larjen e duarve, nëse nuk është e mundur, sanitizues në bazë alkooli pas bërjes së dërgesave.

## **Punëtorët e mi nuk mund të mbajnë distancën fizike për derisa punojnë, a do të thotë kjo se ata nuk mund të punojnë?**

Gjithmonë nuk do të jetë e mundur që punëtorët dhe të tjerët të mbajnë largësi prej 1.5 metra gjatë tërë kohës në vendin e punës.

Nëse ky është rasti, konsideroni nëse detyra duhet kryer apo mund të shtyhet për më vonë.

Nëse detyra duhet të kryhet dhe punëtorët do të jenë në kontakt të afërt, punëdhënësit duhet të kryjnë një vlerësim të riskut për të përcaktuar çfarë mund të bëjnë ata për të eliminuar apo minimizuar rreziqet e shëndetit dhe sigurisë.

Aty ku është praktike dhe e sigurt për t'u bërë, rishikoni detyrat dhe proceset që përfshinë interakcion të afërt. Identifikoni mënyrat për të modifikuar këto për të rritur distancimin.

Aty ku nuk është e mundur, reduktoni sasinë e kohës që punëtorët e kalojnë në kontakt të afërt dhe zbatoni masa tjera të kontrollit.

Për shembull:

- minimizoni numrin e punëtorëve brenda hapësirës në çdo kohë
- shpërndani fillimin, përfundimin dhe kohët e ushqimit
- dërgoni detyrat e punës në hapësira të ndryshme të vendit të punës, apo jashtë vendit të punës
- ndani punëtorët në ekipe në ndrrimin e njejtë apo në një hapësirë të caktuar – konsideroni nëse ekipet mund të kenë hapësirat e veta për ushqim apo për pushim dhe
- sigurohuni që secili punëtor të ketë pajisjet apo mjetet e veta.

## **Kontrollimi dhe monitorimi në vazhdim e sipër**

Monitoroni dhe kontrollimi i distancimit fizik për t'u siguruar se masat janë duke u ndjekur dhe mbeten efektive.

Nëse masat e distancimit fizik paraqesin rreziqe të reja të shëndetit dhe sigurisë, siç është nëse ato ndikojnë në komunikimin apo rezultojnë në më pak njerëz të kryjnë një detyrë, ju do të duhet të menaxhoni edhe këto rreziqe.

## **Më shumë informacione**

Për më shumë informacione në lidhje me COVID-19 dhe për shëndetin dhe sigurinë në punë, vizitoni uebfaqen [Safe Work Australia website](https://www.swa.gov.au/coronavirus).